

VENDIM
Nr. 20, datë 18.2.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 245, DATË 26.11.2018,
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘RENRGY TRADING GROUP’” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa “a”, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative”, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi “Plotësimin e kushtit të vendosur në vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Renrgy Trading Group’” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, ka vendosur si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Shoqëria brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit të shoqërisë.

3. Shoqëria përpara se të fillojë operimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të njoftojë ERE-n mbi implementimin e sistemit të platformës IT që do të përdorë.

4. Në rastin e mospërbushjes së këtyre kushteve nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 107, datë 1.2.2019 dhe nr. 107/1, datë 8.2.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Organigramën dhe listën e personelit të shoqërisë sipas profilit, të nënshkruara nga administratori,

- Marrëveshjen e datës 9.1.2019, për shërbimin e sistemit IT, me subjektin “Novita d.o.o”.

- Sa më sipër, rezulton se shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”

2. Pikat 2, 3 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego